



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



## **Raport Konsultativ**

**Faktori i Efikasitetit**

**Periudha e Dytë Rregulative (2018-2022)**

### **DEKLARATË**

**Ky Raport është përgatitur nga ZRRE-së me qëllim të informimit të palëve të interesit të sektorit të energjisë. Raporti nuk paraqet ndonjë vendim të ZRRE-së dhe nuk duhet të interpretohet si tillë.**

**24 gusht 2018**



## **Përmbajtja**

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>1</b>
<b>2</b>	<b>Përcaktimi i opex bazë të lejuar dhe roli i faktorëve të efikasitetit .....</b>	<b>1</b>
<b>3</b>	<b>Vlerësimi i përfitimeve të efikasitetit .....</b>	<b>3</b>
<b>4</b>	<b>Përfitimet nga efikasiteti .....</b>	<b>5</b>
4.1	Krahasimi mes vendeve të rajonit .....	5
4.2	Vendimet e Rregullatorëve .....	6
<b>5</b>	<b>Konkluzionet dhe propozimet për PRR2 .....</b>	<b>7</b>



## 1 Hyrje

Ky raport përshkruan qasjen e ZRRE-së për përcaktimin e shpenzimeve operative bazë (“opex bazë”) për Periudhën e Dytë Rregullative (PRR2), rolin e faktorit të efikasitetit dhe mënyrën se si janë nxjerrë këta faktorë të efikasitetit. Ky raport shoqëron raportet konsultative të lëshuara nga ZRRE-ja për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) që do të aplikohen për të licencuarit e operatori të sistemit të transmetimit dhe të tregut (KOSTT sh.a.) dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS sh.a.) gjatë PRR2. Ky opex bazë, i llogaritur duke përdorur faktorët e efikasitetit ashtu siç përshkruhet këtu, është pjesë përbërese e MAR.

ZRRE-ja përdorë termin “opex bazë” për të përfshirë kostot personelit, kostot e mirëmbajtjes dhe shpenzimet tjera të përgjithshme operative. Përjashton kostot e blerjes së energjisë për të mbuluar humbjet e energjisë elektrike në rrjet, kostot e zhvlerësimit, kostot e blerjes së shërbimeve ndihmëse dhe të blerjes së shërbimeve tjera të jashtme siç janë asetet e marra me qira të cilat janë pronë e palëve të treta.

Komentet për këtë Raport Konsultativ mund të dorëzohen në kuadër të komenteve ndaj Raporteve Konsultative për të Hyrat e Lejuara Maksimale. Komentet mund të dërgohen në formë elektronike përmes e-mailit në [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org) ose të dorëzohet në formë të shtypur në adresën e mëposhtme:

Zyra e Rregullatorit për Energji  
Departamenti për Tarifa dhe Çmime  
Rr. Dervish Rozhaja Nr. 12  
Prishtinë, 10000, Kosovë

Data e fundit për komente është **7 shtator 2018**.

## 2 Përcaktimi i opex bazë të lejuar dhe roli i faktorëve të efikasitetit

Qasja e ZRRE-së për përcaktimin e opex bazë të lejuar për PRR2 është si në vijim:


- Vlera e hapjes së opex-it për PRR2 (në vitin 2018) është caktuar e barabartë me vlerën në mbyllje për PRR1 të lejuar (në vitin 2017), duke përfshirë edhe ndonjë komponentë eventual të kostove shtesë që janë jashtë kontrollit të të licencuarve. Kjo mbron konsumatorët dhe të licencuarit ndaj ndryshimeve të theksuara të çmimeve. Kjo gjithashtu i lejon të licencuarit që të mbajnë kursimet ose të bartin humbjet e opex-it të realizuar që ndryshon nga nivelet e lejuara në pajtim me Rregullat e të Hyrave. ZRRE-ja ka zbërthyer opex-in bazë në kategori kryesore dhe jo në detaje në mënyrë që të ruajë fleksibilitetin për të licencuarit për të përcaktuar mënyrën më të mirë të ndarjes së shpenzimeve të lejuara duke siguruar nivelin e kërkuar të cilësisë së shërbimit.
- Kjo vlerë e hapjes pastaj përshtatet për çdo ndryshim në opex-in e pritur që rezulton nga vendosja e përgjegjësisë të reja për të licencuarit ose largimin e përgjegjësisë ekzistuese. Këto mund të përfshijnë, për shembull, obligimet që lindin nga zbatimi i tregut të përbashkët të energjisë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë dhe ndonjë kosto tjetër që është jashtë kontrollit të të licencuarve.



- Vlera e hapjes e përshtatur pastaj kalohet në vitet e mëvonshme në periudhën PRR2 duke e shumëzuar vlerën e çdo viti paraprak me  $(1 - X)$  ku “X” përfaqëson një “faktor efikasiteti” të përcaktuar nga ZRRE-ja<sup>1</sup>.

Kjo qasje është ilustruar më poshtë.

**Figura 1: Qasje e ZRRE-së për përcaktimin e opex bazë të propozuar**



Sipas kësaj metodologjie, faktori X mund të konsiderohet si përmbledhje e tre shtytësve të ndryshëm:

- **Përmirësimet e pritshme të efikasitetit** gjatë periudhës PRR2, që qojnë në reduktimin e kostove të njësisë<sup>2</sup> së të licencuarit dhe, si rrjedhojë, rënie të opex bazës në terma real gjatë periudhës PRR2.
- **Efektet reale të çmimit (ERÇ)**, ku çmimi i inuteve pritët të rritet ose bjerë më shpejt se inflacioni i përgjithshëm i çmimeve të konsumit (ndaj të cilave indeksohen lejimet e opex bazë). Kjo çon në një rritje ose rënie në opex bazë në terma real gjatë periudhës PRR2.
- **Efektet e vëllimit**, kur rritja e madhësisë së rrjetit çon në rritje të kërkesave të inuteve dhe, si rrjedhojë, opex bazë më i lartë në terma real, gjatë periudhës PRR2.

<sup>1</sup> Opex bazë, njëjtë si me komponentët tjerë të MAR, fillimisht përcaktohet në terma real. Lejimi do të azhurnohet çdo vit brenda periudhës PRR2 për inflacionin e çmimit të konsumit dhe faktorin e efikasitetit konform rregullave.

<sup>2</sup> Këto reduktime mund të vijnë nga rezultati i realizimit të çmimeve më të ulta për njësi por pa dëmtuar kualitetin e shërbimit të pritshëm.



Pozita e parazgjedhur e ZRRE-së është se ERÇ është e barabartë me zero. Duhet të jetë e qartë që kjo nuk do të thotë se të gjitha kostot janë konstante të supozuara në terma real por, ngarkesat neto në kostot reale janë zero. Kjo është në përputhje ose me pagat reale konstante (p.sh., pagat mesatare rriten në përputhje me inflacionin) ose rritja e pagave reale duke u kompensuar nga rënia e kostove reale për komponentët tjera të opex-it bazë<sup>3</sup>.

Efektet e vëllimit gjithashtu supozohen nga ZRRE-ja të jenë zero ose afër zeros. Ekzistojnë ekonomizime të shkallës në ofrimin e shërbimeve në rrjetin e energjisë elektrike dhe, si rrjedhojë, duke pasur parasysh raportin e shpenzimeve operative dhe rrjetit ekzistues, ka pak arsye për të supozuar se kostot e opex bazë-it do të rriten për shkak të rritjes së rrjetit.

Prandaj, në vlerësimin e faktorëve të efikasitetit, ZRRE-ja është përqendruar në të parin nga këta shtytës - atë të përmirësimeve të pritshme të efikasitetit. **X-faktorët e propozuar për përdorim në llogaritjen e opex-it bazë janë vendosur të barabartë me vlerësimet e ZRRE-së për përfitimet e mundshme të efikasitetit në kostot për njësi.**

### 3 Vlerësimi i përfitimeve të efikasitetit

Përfitimet potenciale të efikasitetit mund të zërthehen në dy pjesë:

- **Efikasiteti catch-up** - paraqet kohën e pritur për të cilën ndërmarrja do të arrij efikasitetin e ndërmarrjeve me performancën më të mirë (ose "frontier").
- **Efikasiteti frontier** - paraqet shpejtësinë me të cilën kompanitë frontier po bëhen më efikase me kalimin e kohës, në veçanti si rrjedhojë e përmirësimit teknologjik.


Ky koncept është ilustruar më poshtë.

---

<sup>3</sup> Ndikimi i ndryshimeve të tilla në kosto reale varet nga shtesa relative e artikujve të ndryshëm të koston në kostot totale të të licencuarve dhe në Indeksin e Çmimeve të Konsumatorit (CPI) në tërë ekonominë. Për shembull, nëse kostot e bakrit krijojnë 1% të CPI por 10% të kostove të KOSTT-it, atëherë një rënie prej 10% në çmimin e bakrit do të zvogëlonte CPI-në për 0.1% por do të zvogëlonte kostot e KOSTT-it për 1%. Efekti real i çmimit në këtë rast do të ishte -0.9%.



Figura 2: Komponentët e përfitimeve të efikasitetit



Vlerësimi i përfitimeve të efikasitetit, veçanërisht niveli i atyre ekzistuese në raport me jo-efikasitetin dhe, rrjedhimisht, potenciali për ti arritur ato përfitime, është sfidues. Përderisa ekzistojnë shumë metodologji, të gjitha varen nga përdorimi i grupeve të të dhënave kualitative dhe konsistente për një numër të madh të ndërmarrjeve të ngjashme gjatë shumë viteve. Të dhënat e tilla është vështirë të gjinden në industrinë e energjisë elektrike në shumicën e rasteve, mirëpo kjo mund të realizohet me anë të krahasimeve mes vendeve dhe operatorëve me karakteristika të ngjashme.

Domosdoshmërisht, kjo i shtyn vlerësimet e përfitimeve të efikasitetit për Kosovë të mbështeten më shumë në krahasimet ndërkombëtare. Krahasimet e tilla janë sfiduese, duke pasur parasysh dallimet në nivelet e çmimeve lokale, dallimet në alokim dhe raportim të kostos, dallime në detyrat dhe përgjegjësitë, dallimet në kushtet operative dhe mjedisore, lëvizjet e kursit të këmbimit dhe kështu me radhë. Përshtatjet mund të bëhen për shumë prej këtyre dallimeve, por përshtatjet e tilla në mënyrë të pashmangshme sjellin një subjektivitet të konsiderueshëm në analizë. Ndodh shpesh që ndryshimet në supozimet e bëra mund të çojnë në ndryshime të mëdha në rezultate.

Duke pasur parasysh kufizimet e imponuara nga mungesa e grupit të të dhënave të përshtatshme për Kosovën dhe implikimet kohore dhe në kosto për kërkimin e mbledhjes dhe analizimit të një grupi të përshtatshëm të krahasuesve ndërkombëtarë, ZRRE-ja në vend të saj ka zgjedhur që të nxjerr prova për përfitimet potenciale të efikasitetit nga një gamë e burimeve për të propozuar faktorët e efikasitetit. Kjo rezulton që ZRRE në vlerësimin e saj të bazohet në burime të ndryshme të të dhënave si prova. Për të miratuar këtë qasje, ZRRE-ja nuk ka kërkuar që të bëjë dallimin në mes të komponentëve catch-up dhe fronties të përfitimeve të efikasitetit dhe, rrjedhimisht, nuk ka krijuar një pikëpamje eksplicite për nivelin e tanishëm të efikasitetit të KOSTT-it dhe KEDS-it krahasuar me atë të krahasuesve me performancën më të mirë.



Burimet e shqyrtuara janë:

- **Normat e ndryshimit në kostot për njësi të arritura nga OST/OT-të dhe OSSH-të tjera në rajonin e Evropës Juglindore.** Këto ofrojnë një indikator se çfarë kanë qenë në gjendje të arrijnë ndërmarrjet krahasuese në rajon. Ky shqyrtim nuk ka për qëllim që të jetë gjithëpërfshirës, është i kufizuar në vlerësimin e ndryshimit në një përzgjedhje të treguesëve të kostos për njësi për ato ndërmarrje për të cilat të dhënat përkatëse janë të qasshme për publikun.
- **Vendimet nga rregullatorët tjerë për normat e përmirësimit të efikasitetit për t'u përfshirë në kontrollin e çmimit për të licencuarit e transmetimit dhe shpërndarjes.** Këto ofrojnë një tregues se çfarë konsiderojnë si të arritshëm rregullatorët për të licencuarit që operojnë në një ambient të ngjashëm në aspektin e përfitimeve të efikasitetit nga rrjetet e rregulluara të energjisë.

## 4 Përfitimet nga efikasiteti

### 4.1 Krahasimi mes vendeve të rajonit

ZRRE-ja ka krahasuar performancën e KOSTT-it në lidhje me përmirësimin e opex-it bazë<sup>4</sup> (efikasitetit) me OST-të tjera në Bullgari, Maqedoni, Mali i Zi dhe Rumani. Krahasimi tregon se:

- Opex bazë i KOSTT-it ka qenë në rritje, ndërsa tre nga katër krahasuesit rajonalë kanë arritur të ulin kostot. Kjo tregon që efikasiteti operativ i KOSTT-it është përkeqësuar me kalimin e kohës<sup>5</sup>.
- Në mesin e krahasuesve, ndryshimet në opex bazë kanë shkuar nga 3.0% në -3.5% me një mesatare të thjeshtë prej -0.9%. Ndryshimet në opex për njësi kanë shkuar nga 2.6% në -3.8% me një mesatare të thjeshtë prej -0.1%.

Këto krahasime janë paraqitur më poshtë. Për konsistencë në përdorimin e këtyre të dhënave për përcaktimin e faktorëve të efikasitetit, rëniet në opex bazë janë të treguara si përmirësime të efikasitetit (p.sh., një ulje në opex për njësi prej -3.8%, këtu është paraqitur si një rritje e nënkuptuar në efikasitetin opex prej 3.8% në vit).


---

<sup>4</sup> Opex bazë në këtë krahasim është shuma e shpenzimeve të punonjësve, materialeve, riparimeve, mirëmbajtjes dhe opex-it tjetër. Përfshijë zhvlerësimin dhe blerjen e energjisë balancuese, energjisë për të mbuluar humbjet dhe shërbimet ndihmëse.

<sup>5</sup> KOSTT-i ka sqaruar se kufizimet në para të gatshme nënkuptojnë se, historikisht, ka shpenzuar më pak në raport me nivelet efikase të opex-it dhe vetëm tani është duke arritur ato nivele.



**Figura 3: Përmirësimet e opex të produktivitetit në mesin e krahasuesve rajonal të OST-ve**



*Burimet: Hartuar nga ZRRE-ja nga pasqyrat financiare të publikuara. Të gjitha kostot janë konvertuar në çmimet e 2016 duke përdorur vlerat mesatare të CPI të publikuara nga FMN-ja. Kostot për njësi janë llogaritur duke i ndarë sipas konsumit të energjisë elektrike ashtu siç janë raportuar nga Eurostat, për çështje konsistence.*

Krahasimet në mes të KEDS-it dhe OSSH-ve rajonale janë më të vështira. Ndarja e aktiviteteve të furnizimit dhe ristrukturimi pasues i KEDS-it dhe OSSH-ve rajonale nënkupton që krahasimet e vazhdueshme të kostove me kalimin e kohës nuk janë të mundshme nga të dhënat që janë në dispozicion të publikut, në shumicën e rasteve. Prandaj, ZRRE-ja nuk ka paraqitur një krahasim të tillë në këtë raport.

## 4.2 Vendimet e Rregullatorëve


Burimi i dytë i të dhënave të cilave i është referuar ZRRE-ja janë faktorët e efikasitetit (faktorët X) të aplikuar nga një numër i rregullatorëve Evropian në vendimet e fundit për të hyrat e lejuara për operatorët e rrjeteve të energjisë elektrike. Jo të gjithë rregullatorët vendosin një faktor eksplicit të efikasitetit dhe si pasojë grupi i të dhënave që janë në dispozicion është pashmangshëm i kufizuar. Megjithatë, kjo mund të ofrojë një udhëzues se çfarë konsiderojnë rregullatorët tjerë si të arritur në lidhje me përmirësimet e efikasitetit për shërbimet e rregulluara të cilët, në përgjithësi, kanë operuar nën regjimet e bazuara në stimuj për kohë më të gjatë se Kosova dhe të cilët kanë filluar nga një pikë më e afërt me efikasitetin frontier se sa që mund të pritët për KOSTT dhe KEDS. Prandaj, këto mund të shihen si përfaqësuese të vlerave drejt fundit të asaj që duhet të arrihet nga KOSTT-i dhe KEDS-i.





Faktorët e efikasitetit X të parë variojnë nga 0.7% deri 3.0% në vit (ku një vlerë pozitive paraqet përmirësimin e pritshëm të produktivitetit) me një mesatare të thejshhtë prej 1.9%. Kjo mund të interpretohet se rregullatorët mesatarisht parashohin një ulje në opex prej 1.9% në vit në terma real.

**Figura 4: Vendimet e rregullative të BE-së për faktorët e efikasitetit**



Burimet e përdorura:<sup>6</sup>

## 5 Konkluzionet dhe propozimet për PRR2

ZRRE-ja është në dijeni që përcaktimi i potencialit për të rritur efikasitetin dhe përshtatjet përkatëse për t'u përfshirë në kontrollin e çmimeve është sfidues. Kjo është veçanërisht kështu në një vend si Kosova që ka vetëm një të licencuar për transmetim dhe një për shpërndarje.

Në të njëjtën kohë, ZRRE-ja nuk e konsideron si të arsyeshëm të supozohet se nuk ka potencial për KOSTT-in dhe KEDS-in që të bëjnë përmirësime të efikasitetit gjatë rrjedhës së PRR2. Për të bërë këtë do të nënkuptonte që të dy kompanitë janë duke operuar në nivelin më të mirë të praktikës së efikasitetit dhe se kjo praktikë më e mirë do të mbetet e pandryshuar në vitet e ardhshme. Sipas mendimit të ZRRE-së, këto janë supozime jopraktike, bazuar në rrethanat aktuale.

Duke pasur parasysh bazën e kufizuar të të dhënave ku mund të bazohet, ZRRE-ja propozon që të përcaktohen faktorët e efikasitetit për PRR2 duke përdorur gjykimin e ekspertëve, si dhe duke u mbështetur në krahasimin me performancën rajonale dhe vendimet e rregullatorëve tjerë. Këto krahasime janë paraqitur më lart dhe tregojnë shtrirjet e mundshme për përmirësime vjetore në

<sup>6</sup> Burimet e përdorura janë në dispozicion në:

[https://www.acm.nl/sites/default/files/old\\_publication/publicaties/17231\\_incentive-regulation-of-the-gas-and-elektricity-networks-in-the-netherlands-2017-05-17.pdf](https://www.acm.nl/sites/default/files/old_publication/publicaties/17231_incentive-regulation-of-the-gas-and-elektricity-networks-in-the-netherlands-2017-05-17.pdf), [http://www.medreg-regulators.org/Portals/45/capacitybuilding/1st/1st\\_MEDREG\\_Capacity\\_building-AEESI-Lanza.pdf](http://www.medreg-regulators.org/Portals/45/capacitybuilding/1st/1st_MEDREG_Capacity_building-AEESI-Lanza.pdf), [http://www.ey.com/Publication/vwLUAssets/Mapping\\_Power\\_and\\_Utillities\\_Report\\_2013/\\$FILE/EY%20European%20Power%20regulatory%20report%20FINAL%200513.pdf](http://www.ey.com/Publication/vwLUAssets/Mapping_Power_and_Utillities_Report_2013/$FILE/EY%20European%20Power%20regulatory%20report%20FINAL%200513.pdf) dhe [https://www.ceer.eu/documents/104400/3731873/C16-IRB-29-03\\_Investment+Conditions\\_24-Jan-2017.pdf/44a08bad-efe7-01da-8b37-a3dd7edccfd5](https://www.ceer.eu/documents/104400/3731873/C16-IRB-29-03_Investment+Conditions_24-Jan-2017.pdf/44a08bad-efe7-01da-8b37-a3dd7edccfd5).



efikasitetin e shpenzimeve operative duke filluar nga -2.6% në 3.8% bazuar në krahasuesit rajonalë, dhe prej 0.7% deri 3.0% në vit bazuar në vendimet e rregullatorëve tjerë.

Duke pasur parasysh këto shtrirje, ZRRE-ja propozon që të përcaktojë një faktor efikasiteti për opex prej 1.5% në vit për KOSTT-in dhe KEDS-in gjatë PRR2.

Tabela 1: Faktorët e efikasitetit të propozuar nga ZRRE për PRR2

Faktorët e efikasitet të propozuar nga ZRRE	2018	2019	2020	2021	2022
OST/OT	-	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%
OSSH	-	1.5%	1.5%	1.5%	1.5%

**Duke pasur parasysh këto shtrirje, ZRRE-ja propozon që të përcaktojë një faktor efikasiteti për opex prej 1.5% në vit për KOSTT-in dhe KEDS-in gjatë PRR2.** Kjo bie në përgjithësi në mes të shtrirjeve të aplikuara nga rregullatorët tjerë dhe rreth dy të tretat lartë shtrirjes së kostove të krahasuesve, që nënkupton se paraqet një cak, i cili është i arritshëm.

Faktori ndarës i kursimeve për kursimet që tejkalojnë faktorin efikasitetit për shenzimet operative do të ndahen ndërmjet të licencuarit dhe konsumatorëve sipas faktorit 50/50. Në rastin e tejkalimeve të shpenzimeve mbi nivelin e lejuar, ato do të mbulohen nga të licencuarit në pajtim me Rregullat për të Hyrat.